

GAZETARIA NË MESIN E PENSIONISTËVE

TAKIMI I SUKSESSHËM ME KORRESPONDENTËT E LSHPM

Informimi në LSHPM si detyrim ligjor bëhet para së gjithash përmes botimit të gazetës "Penzioner Plus", faqes për pensionistët në gjuhën shqipe në gazetën "KOHA" në të cilën një përzgjedhje artikujsh publikohet, nëpërmjet faqes sonë të internetit, si dhe përmes mediave të tjera të shkruara dhe elektronike në vendin tonë në nivel lokal dhe kombëtar

Më 28 shtator të këtij viti, u mbajt një takim me korrespondentët e gazetës "Penzioner Plus", gazetës "KOHA" dhe uebsajtit të Lidhjes, ku mori pjesë edhe kryetarja e Këshillit botues të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova. Takimi u mbajt sipas Programit të Lidhjes që synon përmirësimin dhe promovimin e informacionit në LSHPM, i cili është i dyanshëm dhe është shumë i rëndësishëm për shoqatat dhe LSHPM për prezantim transparent të ngjarjeve.

Takimin e hapi dhe e drejtoi kryeredaktorja e gazetës "Penzio-



ner Plus", Kalina Slivovska-Andonova. Ajo përsëndeti të gjithë, duke shprehur kënaqësinë që me praninë e tyre tregojnë qëndrimin e tyre të përgjegjshëm ndaj rëndësisë së informimit në LSHPM.

Fillimisht të pranishmëve iu drejtua kryetarja e Këshillit botues dhe LSHPM-së, Stanka Trajkova. "Të nderuar të pranishëm, informimi në LSHPM si detyrim ligjor bëhet para së gjithash përmes botimit të gazetës "Penzioner Plus", faqes për pensionistët në gjuhën shqipe në gazetën "KOHA" në të cilën një përzgjedhje artikujsh publikohet, nëpërmjet faqes sonë të internetit, si dhe përmes mediave të tjera të shkruara dhe elektro-

nike në vendin tonë në nivel lokal dhe kombëtar.

Në shumë shoqata kërkohen dhe gjenden mënyra të ndryshme që "Penzioner Plus" të arrijë te pensionisti, por duhet të jetë edhe më aktiv dhe më i intensifikuar dhe për këtë duhet të përpqemi të gjithë për të arritur sa më shumë lexues. Gjatë kësaj periudhe të kaluar janë bërë përpjekje për përmirësimin e përmbajtjes së "Penzioner Plus" me përmbajtje të reja. Ne duam të ndryshojmë pamjen e gazetës, por transparencja duhet të jetë ende e pranishme në çdo artikull. Jeni korrespondentë të një gazete të LSHPM -së dhe pritët të përballeni me të gjitha sfidat, të

ndiqni dhe të afirmoni aktivitetet dhe projektet e iniciuara nga shoqatat dhe LSHPM, si çështje të rëndësishme për pensionistët. Dua të them diçka edhe për lajmet e rreme që po përhapen në rrjetet sociale. Të gjithë duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos lejojmë askënd të na prishë dinjitetin dhe të nënçmojë punën dhe rezultatet tona dhe kjo do të arrihet me artikujt tuaj që promovojnë qartë të vërtetën. Nuk duhet të jetë debat para syve, por thjesht prezantim i fakteve dhe provave", theksoi Trajkova.

Pas prezantimit të saj afirmativ dhe inkurajues, të gjithë u prezantuan për t'u njohur me njëri-tjetrin dhe në të ardhmen për të shkëmbyer përvoja dhe njohuri për probleme dhe çështje të caktuara.

Më pas në takim foli kryeredaktorja e gazetës "Penzioner Plus" Kalina Slivovska-Andonova. "E keni dëgjuar prezantimin e kryetares Trajkova. Sot do të flas për disa gjëra praktike që do të përmirësojnë dhe lehtësojnë aktivitetin tuaj korrespondent në kuptimin teknik dhe gazetaresk. Siç e dini sot, kompjuteri dhe interneti janë bërë pjesë e pandashme e jetës edhe të

të moshuarve. Sot interneti dhe kompjuteri na e kanë bërë punën më të lehtë dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme të jemi njohës kompjuterik dhe mediatik. Dhjetëra vjet më parë, shumë njerëz nga brezi i vjetër jo vetëm që nuk e përdornin internetin këtu, por as nuk dinin ta përdornin. Për çfarë do ta përdornin? Sot një numër i madh njerëzish e përdorin edhe nga moshja e tretë dhe dita-ditës po bëhet pjesë e pandashme e jetës. Ajo që edukon, informon dhe komunikon. Fakti që të gjithë jeni gjithnjë e më shumë të suksesshëm dhe më pak të varur nga ndihma e njerëzve të tjerë kur bëhet fjalë për kompjuterin është i kënaqshëm. Për të qenë edhe më të mirë dhe më të pavarur, kam përgatitur për ju material me këshillat më elementare që duhet të praktikoni kur krijoni artikujt tuaj. Mes jush ka gazetarë me përvojë, por edhe amatorë të apasionuar. Në mënyrë që artikulli të jetë i mirë dhe i qartë, duhet të mbani gjithmonë parasysh këto pesë fjalë: kush, çfarë, ku, kur dhe si!", theksoi Slivovska-Andonova. Më pas pati një diskutim nga të pranishmit. Në takim u sollën edhe konkluzionet. (K.S.A)

OLIMPIADA SPORTIVE E PENSIONISTËVE BRVENICA 2023

Sportistët më të mirë, pensionistët nga Shtipi

U shpallën fituesit në të gjitha disiplinat dhe fituesi i përgjithshëm, Shoqata e pensionistëve nga Shtipi. Vendin e dytë e zunë sportistët e Shoqatës Gazi Baba, ndërsa të tretin nikoqirët, sportistët pensionistë nga Tetova

Më 17 shtator, për nder të Ditës së pensionistëve të Maqedonisë, dhe në emër të festës së Pavarësisë së vendit tonë, Republikës së Maqedonisë së Veriut, u mbajtën Garat e 27-ta sportive të pensionistëve të Republikës së Maqedonisë.

Numrin e madh të të pranishmëve fillimisht i përsëndeti dhe i mirëpriti në gjuhën maqedonase dhe shqipe kryetari të Shoqatës së pensionistëve nga Tetova, Selver Memeti. Më pas mysafirët dhe konkurrentët me fjalë të zgjedhura i përsëndeti sekretari i Komunës, Goran Jovanovski. Pas fjalëve të tyre, para sportistëve dhe të ftuarve iu drejtua kryetarja e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Stanka Trajkova, e cila ndër të tjera tha, "Të nderuar të pranishëm, me kënaqësi të veçantë ju përsëndes të gjithë juve që erdhët në këtë ngjarje të madhe dhe domethënëse tonë. Ga-



rat e sotme sportive të 27-ta radhazi kombëtare i kanë paraprirë 8 lojëra sportive rajonale në të cilat pensionistët garuan në të gjitha disiplinat sipas Rregullores sportive. Kishte një entuziazëm të madh për të fituar, për të fituar të paktën një vend të parë për të marrë pjesë në garat republikane. Të nderuar, të 53 shoqatat anëtare të Lidhjes morën pjesë në lojërat rajonale me 1.584 garues, nga të cilët 1.028 në konkurrencën e meshkujve dhe 553 në konkurrencën e femrave. Gjithsesi morën pjesë dhe u socializuan 2215 përfitues të pensionit. Megjithatë, këtë vit, 43 shoqata me gjithsej 371 garues, 224 në garat e meshkujve dhe 147 në femra, arritën të kualifikohen në garat e republikane me garuesit e tyre. Sot në Garat e 27-ta sportive republikane pres një sportivitet të ndershëm dhe mund të fitojë më i miri, por më e rëndësishmja mendoj se është të marrim pjesë dhe të përgëzoj fituesin. Ndaj, jam krenare për të gjithë ju që të gjithë

ndërtojmë bashkëjetesë dhe miqësi sa i përket sportit. Luani sport, gëzohuni dhe ndani lumturinë me kolegët tuaj sportistë. Shpall të hapur Garat e 27-ta sportive republikane të pensionistëve në Bërvenicë-Tetovë në vitin 2023".

Pas fjalimit të saj, garat filluan sipas rregullave të paracaktuara dhe vendosura në Rregulloren për gara sportive, për të cilat sqarime plotësuese dha Zdravko Petkovski, kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion pranë KE të Lidhjes. Pastaj u shpallën fituesit në të gjitha disiplinat dhe fituesi i përgjithshëm, Shoqata e pensionistëve nga Shtipi. Vendin e dytë e zunë sportistët e Shoqatës Gazi Baba, ndërsa të tretin nikoqirët, sportistët pensionistë nga Tetova.

Olimpiada sportive e pensionistëve Bërvenicë 2023, e organizuar nga Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, me nikoqir të SHP Tetovë, përfundoi me shoqëri dhe kënaqësi sepse të gjithë ndiheshin fitues. (K.S.A)



Pjesëmarrje e pensionistëve të Maqedonisë në Festivalin në Lubjanë

Në Lubjanë nga data 27 shtator deri më 29 shtator të këtij viti u mbajt festivali i 22-të i moshës së tretë të jetës, manifestimi më i madh i këtij lloji në Evropë. Festivali përmban një program kulturor të mbushur me shfaqje të rreth njëqind grupeve nga Sllovenia dhe jashtë saj, një program edukativ që synon problemet e të moshuarve, si dhe prezantime të produkteve që synojnë përmirësimin e shëndetit të pensionistëve. Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë për herë të 12-të mori pjesë në festival, këtë herë e përfaqësuar nga SHP Qendër dhe SHP Koçani. Më 26 shtator të këtij viti, dy shoqatat udhëtuan për në Lubjanë me një autobus, në një atmosferë të bukur, të shoqëruar nga Menka Temelkovska dhe Dr. Dimitar Dimitrievski. Në ditën e parë të festivalit u mbajt hapja ceremoniale ku morën pjesë pjesëmarrësit tanë dhe ku vetëm ne u përsëndetëm enkas nga organizatori dhe valëvitja e flamurit tonë u prit me duartrokitje nga të pranishmit. Më pas u pasua me performancën e korit të SHP Qendër dhe grupit folklorik të SHP Koçani, të cilët sërish morën duartrokitje nga publiku i cili u bashkua në vallëzim së bashku me të pranishmit, duke krijuar kështu një atmosferë të mrekullueshme mes të pranishmëve. Mikpritësit organizuan një drekë në qendër të Lubjanës për pjesëmarrësit tanë, pas së cilës kaloi një pasdite e mrekullueshme duke vizituar liqenin Bled. Në ditën e dytë të festivalit, pjesëmarrësit tanë përsëri performuan në mesin e të parëve dhe gjatë kësaj kohe përfaqësuesit e LSHPM-së mbajtën një takim me nikoqirët, në të cilin iu ndanë dhuratat përkatëse me simbollet maqedonase dhe u ranë dakord për aktivitete të mëtejshme të përbashkëta. (Dimitar Dimitrievski)